



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-064

Prishtinë, më 4 korrik 2016, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 4 KORRIK 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Driton Lajçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,
Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 13 qershor 2016,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 13 qershor 2016

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 13 qershor 2016.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës:

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishëm në mbledhje, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 7 korrik 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,*
7. *Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,*
8. *Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,*
9. *Zgjedhja e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit,*
10. *Shqyrtimi i raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015,*
11. *Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015,*
12. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015,*
13. *Shqyrtimi i propozimit për shpalljen e 5 Shtatorit - “Dita e Bamirësisë - Nëna Terezë”.*

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Propozimi për shpalljen e 5 Shtatorit – “Dita e Bamirësisë - Nëna Terezë”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin për shpalljen e 5 Shtatorit - “Dita e Bamirësisë - Nëna Terezë”, këtë çështje e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës.

2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016

Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016 e paraqiti dhe e arsyetoi hollësisht sipas vijave buxhetore Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi.

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

3. Kërkesa e deputetit Kujtim Paçaku për mbështetje financiare për organizimin e një takimi me pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kujtim Paçaku, për mbështetje financiare në shumë prej tetëqind (800) euro për organizimin e një takimi me pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: mallra dhe shërbime.

4. Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin nr. 06/88, datë 20.05.2016, të Qeverisë së Kosovës për shpërndarjen e kontigjencës për korrektim të formulës-pjesës së Grantit të Përgjithshëm për vitin 2017 për komuna në vlerë prej 4 000 000 euro

Kryesia, u njoftua me shkrim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin nr. 06/88, datë 20.05.2016, të Qeverisë së Kosovës për shpërndarjen e kontigjencës për korrektim të formulës-pjesës së Grantit të Përgjithshëm për vitin 2017 për komuna në vlerë prej 4 000 000 euro, i cili ka vlerësuar se ekzekutimi i këtij vendimi mund të bëhet pas krijimit të bazës ligjore nëpërmjet ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 03/L-049 për financat publike.

5. Njoftimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me zbatimin e rekomandimeve të këtij komisioni, të miratuara në seanca plenare për disa organizata buxhetore gjatë vitit 2015

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike gjatë vitit 2015 ka mbikëqyrur dhe ka shqyrtuar zbatimin e rekomandimeve, të cilat ky komision i ka dhënë për 10 (dhjetë) organizata buxhetore, bazuar në raportet e auditimit të vitit 2014.

Më pas, ai tha se komisioni i lartpërmendur me anë të raportit dërguar Kryesisë së Kuvendit vetëm na ka njoftuar për nivelin e zbatimit të këtyre rekomandimeve për 10 (dhjetë) organizata buxhetore.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale